



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2600/Prot.
2

Tiranë, më 31 / 05 / 2021

URDHËR

Nr. 359, Datë 31.05.2021

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES
MIRJAM ISUFAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, gërmës “dh”, nënpika “i)”, të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Pranë Ministrisë së Drejtësisë është administruar shkresa nr.303 Prot., (XH.S.), datë 10.05.2021, protokolluar me nr.2600 Prot., datë 14.05.2021, dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, nëpërmjet së cilës jemi njoftuar mbi Urdhërin e Prokurorit nr.171, datë 30.04.2021 “Për ekzekutimin e vendimit nr.252, datë 20.04.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë”.

Nëpërmjet këtij Urdhri, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ndër të tjera ka vendosur *“Ekzekutimin e vendimit penal nr.252, datë 20.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim vuajtjen e dënimit me burgim nga të dënuarit Mirjam Isufi dhe K.J, heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike prej tyre dhe pagimin e shpenzimeve procedurale”*.

Me vendimin nr.252, datë 20.04.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur *“Deklarimin fajtor të të pandehurës Mirjam Isufaj për kryerjen e veprës penale ‘Shpërdorimi i detyrës’, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me 2 (dy) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet zbritja e 1/3 së masës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht 1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim. Në bazë të nenit 35/2 të Kodit Penal, i hiqet të pandehurës Mirjam Isufaj e drejta për të ushtruar funksione publike për një periudhë kohore 2 (dy) vjet”*.

Në këto kushte, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, është urdhëruar ekzekutimi i vendimit penal, lidhur me vuajtjen e dënimit prej 1 vit e 4 muaj burgim, në një burg të sigurisë së zakonshme, nga e dënuara Mirjam Isufaj, si dhe heqja e së drejtës për të ushtruar funksione publike për një periudhë kohore prej 2 vitesh.

Në nenin 4, të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, parashikohet se, “Profesioni i noterit në Republikën e Shqipërisë është një funksion i pavarur, me karakter publik, në shërbim të personave fizikë dhe juridikë, i cili ushtrohet nëpërmjet hartimit të akteve juridike dhe ushtrimit të veprimtarive materiale të tjera, të parashikuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.

Në nenin 21, pika 1 gërma “dh”, nënpika “i”, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, përcaktohet si një nga rastet e heqjes së licencës me urdhrë të ministrit të Drejtësisë rasti kur noteri është dënuar pas martesë së licencës me vendim gjyqësor të formës së prerë: i) për një vepër penale të kryer me dashje.

Në rastin konkret, noterja Mirjam Isufaj është dënuar me vendimin nr.252, datë 20.04.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka marrë formë të prerë, për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Po të analizohet vepra penale për të cilën është dënuar noterja “Shpërdorim i detyrës”, dispozita përcakton se: “Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbyshje të rregullit të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dënuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”.

Nga sa më sipër rezulton se jemi përpara kushteve për aplikimin e pikës 1 gërma “dh/i” të nenit 21, të ligjit 110/2018 “Për noterinë”, pasi:

- Vepra penale e kryer nga noterja është kryer në formën e dashjes;
- Vendim penal është i formës së prerë.

Sa më sipër, duke vlerësuar se detyra e noterit ka karakter publik dhe figura e reputacioni i personit që ushtron këtë funksion ka një rëndësi të veçantë mbi besimin e publikut në figurën e noterit, si dhe duke qenë se nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendosur deklarimi fajtor për kryerjen e vepërës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, bazuar në nenin 21, pika 1, gërma “dh”, nënpika “i”, të ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, përcaktohet se “Hegja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhrë të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri:...dh) është dënuar pas martesë së licencës me vendim gjyqësor të formës së prerë. i) për një vepër penale të kryer me dashje”,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noteres Mirjam Isufaj, anëtare e Degës Vendore të Noterisë Vlorë.

2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Znj. Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- b) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Vlorë, brenda 7 ditëve nga marrja dëni e këtij Urdhri;
- c) Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

3. Nxjerijen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Mirjam Isufaj, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij Urdhri.

4. Dega Vendore e Noterisë Vlorë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijani e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për noterinë".

5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noteriale, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivore, nëse ka të tilla.

6. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 4, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 10 ditëve pune.

7. Ndaj këtij urdhri, noterit mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.

8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistronen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Vlorë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastritimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.

11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokolit për njoftimin e këtij Urdhri noterës Mirjam Isufaj dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

MINISTRI

E. Gjonaj

Etilda Gjonaj (Salut)

